

AKT NORMATIV
Nr. 1, datë 31.1.2020

**PËR MASAT PARANDALUESE NË KUADËR TË FORCIMIT TË LUFTËS
KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR, KRIMEVE TË RËNDA DHE
KONSOLIDIMIT TË RENDIT E SIGURISË PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky akt normativ përcakton masat parandaluese me karakter të përkohshëm në kuadër të forcimit të luftës ndaj organizatave dhe grupeve të strukturuar kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura, individëve të përfshirë në krime të rënda, si dhe procedurat, kompetencat e kriteret për zbatimin e këtyre masave ndaj subjekteve të këtij akti normativ.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij akti normativ është ndërhyrja emergjente dhe me karakter të përkohshëm në kushtet e nevojës së forcimit dhe ashpërsimit të luftës kundër krimit të organizuar, organizatave dhe grupeve të strukturuar kriminale, si dhe çdo grupi tjetër kriminal e terrorist, bandave të armatosura, individëve të përfshirë në krimet e rënda, me synim konsolidimin e sigurisë në vend, përmes rritjes së kapacitetit dhe nivelit të zbulimit, gjurmimit dhe parandalimit të krimit të organizuar, krimeve të rënda, terrorizmit dhe përdorimit prej krimit të organizuar të pronave me origjinë të paligjshme.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e këtij akti normativ zbatohen vetëm ndaj subjekteve dhe pasurive të subjekteve të parashikuara në nenin 5 të këtij akti normativ, vetëm për kohën dhe kushtet e parashikuara taksativisht në të.

2. Masat parandaluese me karakter pasuror, të parashikuara në këtë akt normativ, nuk vendosen mbi pasurinë që, para hyrjes në fuqi të këtij akti normativ, është në proces shqyrtimi gjyqësor ose për të cilën është disponuar me vendim gjykate në zbatim të legjislacionit penal, ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, si dhe legjislacionit mbi financimin e terrorizmit.

Neni 4
Parimet

Parimet bazë të zbatimit të këtij akti normativ, janë:

1. Respektimi i lirisë dhe i të drejtave themelore të njeriut në interpretim dhe në zbatim të përcaktimeve të KEDNJ-së dhe praktikës së konsoliduar të GJEDNJ-së;
2. Domosdoshmëria dhe proporcionaliteti i përdorimit të masave parandaluese sipas parashikimit të këtij akti normativ;
3. Sekretet e kryerjes së veprimeve;

4. Rritja e sigurisë publike dhe parandalimi i përfitimit prej aktivitetit kriminal, objekt i këtij akti normativ.

Neni 5 Subjektet

Subjekte të këtij akti normativ, janë:

1. Personat, që deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ janë dënuar me vendim penal të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të personave për të cilët ka vendim pafajësie, për:

a) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga organizata kriminale, banda e armatosur dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal;

b) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga organizata terroriste e të krimeve për qëllime terrosiste, parashikuar nga kreu VII i Kodit Penal;

c) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 109, 109/b, 110/a, 114, 117, 128/b, 134, paragrafi i tretë, 136, 138/a, 139, 140, 141, 151, 152, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284 dhe 284/a, të Kodit Penal;

2. Personat, që deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ janë persona nën hetim, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të personave për të cilët ka vendim të pushimit të akuzës apo të çështjes penale, për:

a) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga organizata kriminale, banda e armatosur dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal;

b) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga organizata terroriste e të krimeve për qëllime terrosiste, parashikuar nga kreu VII i Kodit Penal;

c) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 109, 109/b, 110/a, 114, 117, 128/b, 134, paragrafi i tretë, 136, 138/a, 139, 140, 141, 151, 152, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284 dhe 284/a, të Kodit Penal;

3. Personat fizikë dhe juridikë, shtetas shqiptarë apo të huaj, si dhe persona pa shtetësi, për të cilët ka filluar procedura e shpalljes apo për të cilët ekzistojnë dyshime të bazuara në elemente të faktit për përfshirje në çdo formë të terrorizmit dhe të financimit të tij, të kryera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi, për masat kundër financimit të terrorizmit.

Neni 6 Përkufizime

Në kuptim të këtij akti normativ, termat si më poshtë kanë këtë kuptim:

1. “Konfiskim” është kalimi në favor të shtetit, heqja e së drejtës së pronësisë me urdhër të autoritetit kompetent në kushtet e privimit të plotë apo të pjesshëm dhe pa kompensim të pasurisë që buron drejtpërdrejt apo tërthorazi nga krimi.

2. “Pasuri” janë asetet të cilitdo lloji, llogari bankare, para (cash), pasuri të lujatshme, pasuri të paluajtshme, përfshirë edhe ato në proces legalizimi, çdo dokument apo instrument tjetër që përbën titull për të drejta dhe interesa mbi këto aset.

3. “Aktivitete antiterroriste” janë aktivitete të organeve publike me qëllim parandalimin e ngjarjeve me natyrë terroriste, kontrollin e këtyre ngjarjeve nëpërmjet aksioneve konkrete, eliminimin e pasojave, duke përfshirë bllokimin / sekuestrimin / konfiskimin e burimeve me qëllim reagimin ndaj këtyre ngjarjeve.

4. “Operacioni Forca e Ligjit (OFL)” është strukturë e veçantë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

5. “Element i faktit” është tërësia e të dhënave apo njohurive që sigurohen nga policia në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj në zbatim të legjislacionit përkatës dhe që vlerësohet se mund të përbëjnë faktin, ngjarjen apo rrethanë të faktit.

Tipologjia e masave parandaluese të këtij akti normativ dhe marrëdhënia me procedime të tjera

1. Masat parandaluese me karakter personal dhe pasuror, të parashikuara në këtë akt normativ mund të zbatohen së bashku ose veçmas në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. Masat parandaluese me karakter ekonomik zbatohen të lidhura me masat parandaluese me karakter personal e ato pasuror.

2. Procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, të parashikuara nga ky akt normativ, është e pavarur nga gjendja, shkalla, fillimi apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet apo procedimi që mund të zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij akti normativ apo procedimeve të tjera, në kuadër të ligjeve të tjera.

3. Në rastet kur pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara, sipas këtij akti normativ, i nënshtrohen, gjithashtu, sekuestrimit apo konfiskimit, sipas Kodit të Procedurës Penale, ose ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, gjykata, kryesisht ose me kërkesë të prokurorit urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masave parandaluese të sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas këtij akti normativ.

Pezullimi përfundon me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e këtyre masave. Kundër vendimit të gjykatës, subjekti mund të bëjë ankim sipas parashikimeve të këtij akti normativ.

4. Pavarësisht nga zbatimi i dispozitave të këtij akti normativ, prokuroria dhe gjykata apo ministri përgjegjës për financat, në zbatim të dispozitave procedurale penale, të legjislacionit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë apo të legjislacionit për masat kundër financimit të terrorizmit, mund të procedojnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e fondeve dhe të pasurive të tjera, të bllokuara përkohësisht ose të sekuestruara.

Neni 8

Komiteti Kombëtar i Koordinimit për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar

1. Në kuadër të koordinimit të veprimtarisë për hartimin, monitorimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e masave parandaluese, të parashikuara në këtë akt normativ, si dhe për qëllim të shkëmbimit të informacionit e të forcimit të bashkëpunimit me autoritetet e huaja ligjzbatuese, gjatë kohës dhe për efekt të zbatimit të këtij akti normativ, krijohet Komiteti Kombëtar i Koordinimit për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar.

2. Komiteti kryesohet nga ministri i Brendshëm dhe ka në përbërje ministrin e Drejtësisë, ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Prokurorin e Përgjithshëm, drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit, drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, drejtorin e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave.

3. Komiteti është përgjegjës, për:

- ndjekjen dhe zbatimin e politikave dhe harton planin e masave për bashkërendimin e veprimeve për të parandaluar dhe goditur/luftuar krimin e organizuar, terrorizmin;
- vlerësimin e ecurisë së zbatimit të masave parandaluese të dhëna apo të aplikuara në zbatim të këtij akti normativ;
- koordinimin, dhënien e mendimeve, si dhe orientimeve në lidhje me ndjekjen e praktikave më të mira në lidhje me procedurat e zbatimit të masave parandaluese;
- si dhe për çështje të tjera, që lidhen me bashkëpunimin ndërinstitucional, në kuadër të angazhimit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe terrorizmit.

4. Komiteti mblidhet të paktën një herë në tre muaj dhe i paraqet raport periodik Këshillit të Ministrave. Komiteti, me propozimin e ministrit të Brendshëm, miraton rregulla të hollësishme për funksionimin e tij.

Neni 9

Gjykata dhe prokuroria kompetente në kuptim të këtij akti normativ

1. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese dhe kundërshtimi i masave të marra sipas përcaktimeve të këtij akti normativ shqyrtohen në shkallë të parë, nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Ankimimi kundër vendimeve të gjykatës në lidhje me vendosjen e masave parandaluese sipas pikës 1, të këtij neni, shqyrtohet në Gjykatën e Apelit, në juridiksionin e së cilës janë çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

3. Prokuroria kompetente, në kuadër të masave të parashikuara në këtë akt normativ, është Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

KREU II

MASAT PARANDALUESE PERSONALE

Neni 10

Masat parandaluese personale që ndërmerren nga autoritetet e sistemit të drejtësisë

1. Ndaj personave të parashikuar në nenin 5 të këtij akti normativ, për të cilët ka dyshime të arsyeshme bazuar në elemente të faktit për pjesëmarrje në veprimtari terroriste apo pjesë e organizatës terroriste, bandës së armatosur apo organizatës kriminale dhe kryerjen e krimeve të rënda, me kërkesë të arsyetuar të OFL-së, Prokurori i kërkon gjykatës kompetente, sipas përcaktimit të këtij akti normativ, për të vendosur:

a) masën e kufizimit të perimetrit të lëvizjes, detyrimit për largim ose ndalimit për të qëndruar në një apo disa njësi administrative, për një afat deri në 1 vit;

b) masën e nxjerrjes jashtë territorit për shtetasit e huaj për një afat deri në 1 vit;

c) masën e bllokimit apo të ndalimit të përdorimit të pasaportës apo të dokumenteve të tjera identifikuese të vlefshme për daljen jashtë shtetit, për një periudhë kohore jo më pak se 60 ditë dhe jo më shumë se 1 vit;

ç) masën e ndalimit të daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, për një afat deri në 1 vit.

2. Në vendimin e saj sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç” të pikës 1, me iniciativë apo kërkesë të prokurorit, gjykata mund të urdhërojë detyrimin e subjektit:

a) për të mos u larguar nga banesa e deklaruar pa njoftuar paraprakisht tek autoriteti zyrtar mbikëqyrës (struktura policore e vendbanimit të subjektit);

b) për t'i deklaruar autoriteteve të sigurisë publike, përgjegjëse për mbikëqyrjen, oraret dhe vendet ku mund të gjendet çdo ditë, si dhe të paraqitet në ditët e caktuara dhe sa herë kërkohet nga autoriteti mbikëqyrës (struktura vendore e policisë);

c) për të mos marrë pjesë në tubime, organizime publike, aktivitete sportive, social/kulturore.

3. Vendimi i gjykatës i komunikohet autoritetit të sigurisë publike, përgjegjës për mbikëqyrjen, prokurorit, OFL-së, subjektit ndaj të cilit është vendosur masa ose mbrojtësit të tij, të cilët mund të paraqesin ankim në gjykatën kompetente të apelit brenda 30 ditëve nga marrja dijani.

Neni 11

Masat parandaluese personale në rastet e emergjencës

1. Në rastet e nevojës dhe të urgjencës, kur ka informacione apo dyshime të arsyeshme, të bazuara në elemente të faktit që subjektet e parashikuara në pikën 5, të këtij akti përbëjnë rrezik për sigurinë publike dhe për nxitjen e mundësinë e kryerjes së veprave penale, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me kërkesë të OFL-së, mund të vendosë masat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 10, me përjashtim të masës së parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1.

Urdhri i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit bazohet në kriteret e vlerësimit të dyshimit të arsyeshëm bazuar në elemente të faktit, si dhe në kriteret e vlerësimit të nevojës për garantim të sigurisë publike në përputhje me proporcionalitetin e masës së kërkuar.

2. Drejtori i Përgjithëm i Policisë së Shtetit, për shkaqe shëndetësore, familjare apo shkaqe të tjera të dokumentuara dhe të arsyetuara, mund të pezullojë zbatimin e masës për një afat kohor për të cilin zgjat gjendja apo motivi i kërkuar.

3. Masat parandaluese i komunikohen menjëherë dhe sidoqoftë jo më vonë se 24 orë prokurorit kompetent sipas parashikimit të këtij akti. Kur del e qartë se është ngatërruar personi ose nuk është një nga subjektet e parashikuara në nenin 5, të këtij akti normativ, prokurori, me vendim të motivuar, urdhëron heqjen e masës parandaluese.

4. Kur nuk vendos heqjen e masës, prokurori menjëherë, por, në çdo rast, jo më vonë se 72 orë nga vendosja e masës, i paraqet gjykatës kompetente kërkesën për vleftësimin e masës parandaluese.

5. Në vendimin e tij prokurori bazohet në kriteret e dyshimit të arsyeshëm të bazuar mbi elemente të faktit dhe në nevojën për garantim të sigurisë publike dhe proporcionalitetit të masës së vendosur.

6. Gjykata merr vendim për vleftësimin e masës parandaluese brenda 48 orëve nga momenti në të cilin është paraqitur kërkesa e prokurorit. Vendimin e saj gjykata e bazon në kriteret e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në informacione dhe në kriteret e nevojës për garantim të sigurisë publike dhe proporcionalitetit të masës së kërkuar.

7. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim brenda pesë ditëve nga marrja dijeni apo njoftimi i vendimit të gjykatës. Ankimi paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, e cila detyrohet që, brenda 3 ditëve nga realizimi i njoftimeve, të dorëzojë aktet në gjykatën që do të shqyrtojë ankimin.

Neni 12

Raporti i masës parandaluese personale me masat e sigurimit personal

1. Kur ndaj subjekteve të këtij akti normativ janë aplikuar ose aplikohen masat e sigurimit personal, sipas parashikimeve të legjislacionit penal, gjatë kohës së ekzekutimit të tyre nuk mund të zbatohen edhe masat parandaluese personale të parashikuara në këtë akt normativ.

2. Periudha dhe afatet e masave të sigurimit personal, të dhëna sipas legjislacionit penal, nuk përlllogariten si afate të masës parandaluese personale sipas përcaktimit të këtij akti normativ.

Neni 13

Data efektive dhe përfundimi i masës parandaluese personale

Masa parandaluese personale fillon nga dita në të cilën vendimi i komunikohet subjektit dhe përfundon me mbarimin e afatit të përcaktuar në vendim, nëse subjekti i mbikëqyrur nuk ka kryer përgjatë kësaj kohe ndonjë vepër penale.

Neni 14

Ekzekutimi i masës parandaluese personale

1. Në rast se ndaj subjektit janë dhënë masa të sigurimit personal sipas Kodit të Procedurës Penale, ekzekutimi i masës parandaluese personale të dhënë në zbatim të këtij akti normativ, mbetet i pezulluar për aq kohë sa subjekti u nënshtrohet këtyre masave. Me revokimin apo pushimin e masës së sigurimit personal, organi procedues urdhëron vazhdimin e masës parandaluese personale nëse vlerëson se ekzistojnë sërish rrethanat, kushtet dhe nevojat për të cilat ishte vendosur.

2. Nëse gjatë afatit të caktuar, subjekti i mbikëqyrur kryen një krim për të cilin dënohet dhe masa paraprake me karakter personal nuk pezullohet apo pushon, gjykata vlerëson nëse kryerja e këtij krimi mund të përbëjë një tregues të rrezikut të vazhdueshëm të subjektit dhe, në këtë rast, afati fillon përsëri nga dita në të cilën komunikohet dënimi.

KREU III

MASAT PARANDALUESE ME KARAKTER PASUROR

Neni 15
Të përgjithshme

Masat parandaluese me karakter pasuror mund të iniciohen, të propozohen dhe të merren nga Policia e Shtetit, prokurori apo gjykata sipas parashikimeve të këtij akti normativ.

Neni 16
Subjektet

Dispozitat e këtij kreu për masat parandaluese me karakter pasuror do të zbatohen:

- a) për subjektet e përmendura në nenin 5;
- b) për personat fizikë dhe juridikë të njoftuar nga Komiteti i Sanksioneve të Kombeve të Bashkuara ose një organ tjetër kompetent ndërkombëtar për të urdhëruar ngrirjen e fondeve ose burimeve ekonomike, kur ka dyshime të arsyeshme për të besuar se fondet ose burimet mund të shpërndahen, të fshihen ose të përdoren për financimin e organizatave ose aktiviteteve terroriste, përfshirë ato ndërkombëtare;
- c) ndaj pasurive të personave të parashikuar në nenin 5, të këtij akti normativ, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga:
 - i. personat e afërm (bashkëshortët, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit dhe motrat, bashkëjetuesit për periudhën e 5 viteve të fundit), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta;
 - ii. personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e parashikuar në nenin 5, si subjekte të këtij akti normativ, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre.

Neni 17
Verifikimet paraprake

1. Policia e Shtetit kryesisht apo nëpërmjet informacioneve të marra vihet në dijeni për pasuritë që duhen verifikuar, sipas këtij akti normativ.
2. Me marrjen dijeni për pasuritë, që duhen verifikuar, Policia e Shtetit mund të kryejë verifikime, mbledhje të dhënash dhe vënien në dispozicion të çdo informacioni apo dokumenti që vlerësohet i dobishëm për hetimin e mjeteve financiare, të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare e profesionale, mënyrës së jetesës, si dhe të burimeve të të ardhurave të personave, të subjekteve ndaj të cilëve zbatohet ky akt normativ.
3. Për marrjen e informacionit të kërkuar verifikimet mund të bëhen në të gjitha institucionet publike e private të cilat duhet të bashkëpunojnë me strukturat e policisë për dhënien e informacionit të kërkuar në kohë reale.
4. Informacionet e përmendura në këtë nen i njoftohen prokurorit kompetent sipas parashikimeve të këtij akti normativ.

Neni 18
Sekuestrimi i pasurisë me vendim të gjykatës

1. Për personat e parashikuar në nenin 16, në rast se nga verifikimet paraprake të cilat çojnë në dyshimin e arsyeshëm bazuar në elemente të faktit rezulton se posedojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, pasuri, të drejta ose veprimtari ekonomike, tërësisht ose pjesërisht të pajustificuara në raport me nivelin e të ardhurave ose fitimeve që rrjedhin nga veprimtaritë e ligjshme të deklaruara sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, OFL-ja kërkon paraqitjen nga ana e subjekteve, brenda 48 orëve të deklaramit në formën e një vetëdeklarimi në lidhje me:
 - a) burimet e ligjshme të sigurimit të pasurive;
 - b) shkakun e posedimit dhe përcaktimin e masës të së drejtës apo interesit të ligjshëm që gëzon mbi pasuritë, objekt shqyrtimi;

c) sqarimin e mënyrës së fitimit të pasurisë (në veçanti burimin e të ardhurave në rast shitblerjeje);

ç) përcaktimin nëse pasuria ka bashkëpronarë ose është në përdorim të të tretëve apo këta përfitojnë prej saj në një mënyrë tjetër;

d) të ardhurat e ligjshme vjetore;

dh) çdo informacion tjetër lidhur me pasurinë.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me kërkesë të OFL-së, i referon prokurorit, në mënyrë të arsyetuar, çështjen sipas pikës 1, si dhe i kërkon paraqitjen në gjykatë të kërkesës për marrjen e masës së sekuestros. Kërkesa e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duhet të përmbajë:

a) përcaktimin apo përshkrimin e çdo pasurie, objekt i kërkesës;

b) identifikimin e pronarit të dyshuar (pavarësisht vendndodhjes);

c) çdo akt apo provë tjetër, që lidhet me subjektin apo pasurinë, e disponuar nga OFL-ja;

d) deklarin e bërë nga subjekti sipas pikës 1 ose, në mungesë të tij, njoftimin për paraqitjen e deklaramentit.

3. Brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës së drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, prokurori në mënyrë të arsyetuar:

a) kthen kërkesën e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit kur diktohet e nevojshme nga rrethanat e ndjekjes penale, kur del e qartë se është ngatërruar personi ose nuk është një nga subjektet e parashikuara në nenin 16 të këtij akti normativ ose konstaton se pasuria mbi të cilën kërkohet të vendoset masa e sekuestros është pasuri me të dhëna të gabuara apo të justifikuar nga të ardhura vjetore të ligjshme;

b) kërkon informacion të mëtejshëm nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, informacion që i vihet në dispozicion menjëherë. Mosdhënia e informacionit nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, brenda afatit të caktuar sipas pikës 3, nuk pengon këtë të fundit të paraqesë në prokurori një kërkesë të re me të njëjtin objekt dhe subjekt;

c) i paraqet gjykatës kërkesën për vendosjen e masës së sekuestros, duke vënë në dijeni drejtuesin e organit të prokurorisë dhe drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

4. Gjykata, në dhomë këshillimi, shprehet me vendim për vendosjen e masës së sekuestros brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës së prokurorit. Vendimi i gjykatës është i ekzekutueshëm menjëherë.

5. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente të apelit brenda 15 ditëve nga marrja dijeni apo njoftimi i vendimit. Paraqitja e ankimit nuk pezullon zbatimin e masës së sekuestros.

6. Gjykata shprehet me vendim për vlefhtësimin e masës së sekuestros brenda 15 ditëve nga paraqitja e ankimit. Nëse gjykata nuk shprehet brenda këtij afati, shqyrtimi i ankimit vazhdon ndërkohë që masa e sekuestros mbetet në fuqi.

Neni 19

Sekuestrimi i pasurisë nga Policia e Shtetit në rastet e emergjencës

1. Në rastet e nevojës dhe të urgjencës kur ka informacione apo dyshime të arsyeshme, të bazuara në elemente të faktit se pasuritë e subjekteve të parashikuara në nenin 16 të këtij akti, pavarësisht nëse zotërohen apo janë në përdorim apo posedim në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë prej tyre, janë siguruar në mënyrë të pajustificuar në raport me nivelin e të ardhurave apo fitimeve nga veprimtari të ligjshme, të deklaruara sipas përcaktimeve të legjislationit në fuqi, si dhe kur pasuria ka rrezik të tjetërsohet, të asgjësohet, të dëmtohet, të transferohet, të transportohet apo në çdo rast tjetër që dyshohet se mund të rrezikohet zbatimi i një mase të mundshme sekuestroje, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit urdhëron vendosjen e masës së sekuestros.

2. Urdhri që parashikon vendosjen e masës së sekuestros duhet të përmbajë:

a) përcaktimin apo përshkrimin e çdo pasurie, objekt i masës;

b) identifikimin e pronarit të dyshuar (pavarësisht vendndodhjes);

c) shkakun e zbatimit të procedurës së parashikuar në këtë nen.

3. Masa e sekuestros sipas pikës 1 të këtij neni i njoftohet menjëherë subjektit, i cili, brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit, jep vetëdeklarim në lidhje me të gjitha apo ndonjë nga pikat më poshtë:

- i. burimet e ligjshme të sigurimit të pasurive;
- ii. cilësimin e natyrës dhe përcaktimin e masës të së drejtës apo interesit të ligjshëm që gëzon mbi pasuritë, objekt shqyrtimi;
- iii. mënyrën e fitimit të pasurisë (në veçanti burimin e të ardhurave në rast transferimi të pronësisë etj.);
- iv. përcaktimin nëse pasuria ka bashkëpronarë ose është në përdorim të të tretëve apo këta përfitojnë prej saj në tjetër mënyrë;
- v. të ardhurat e ligjshme vjetore;
- vi. çdo informacion tjetër lidhur me pasurinë.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit menjëherë, dhe në çdo rast brenda 72 orëve nga nxjerrja e urdhrin për masën e sekuestros, i referon çështjen prokurorit dhe i kërkon vleftësimin e masës së sekuestros.

5. Brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës nga ana e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, prokurori me vendim të motivuar:

a) vendos heqjen e masës së sekuestros kur diktohet e nevojshme nga rrethanat e ndjekjes penale, kur del e qartë se është ngatërruar personi, nuk është një nga subjektet e parashikuara në nenin 16 të këtij akti, nëse konstaton se masa e sekuestros është vendosur mbi pasurinë e gabuar, apo nëse të ardhurat e subjektit nuk justifikojnë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë;

b) paraqet kërkesën për vleftësimin e masës së sekuestros në gjykatën kompetente sipas parashikimit të këtij akti normativ. Mosrespektimi i afatit për paraqitjen e kërkesës në gjykatë nuk pezullon zbatimin e masës parandaluese.

6. Gjykata shprehet me vendim për vleftësimin e masës së sekuestros brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës së prokurorit kompetent sipas parashikimeve të këtij akti normativ. Nëse gjykata nuk shprehet brenda këtij afati masa e sekuestros mbetet në fuqi.

7. Masa e sekuestros është e vlefshme për një periudhë 4-mujore, duke filluar nga momenti i zbatimit të saj. Në rastin e verifikimeve komplekse, me kërkesë të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, prokurorit, ose kryesisht, gjykata mund të vendosë zgjatjen e afatit të zbatimit të masës së sekuestros edhe për një periudhë tjetër, por jo më shumë se katër muaj.

8. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit brenda 15 ditëve nga marrja dijani apo njoftimi i vendimit. Gjykata shprehet me vendim për vleftësimin e masës së sekuestros brenda 15 ditëve nga paraqitja e ankimit. Nëse gjykata nuk shprehet brenda këtij afati, masa e sekuestros mbetet në fuqi. Paraqitja e ankimit nuk pezullon zbatimin e masës së sekuestros.

Neni 20

Ekzekutimi i sekuestros

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, pasi i ka bërë me dije subjektit të interesuar urdhrin e sekuestros, merr masa për vënien në ekzekutim të tij nëpërmjet dorëzimit të pasurisë, objekt i urdhrin të sekuestrimit, Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

2. Bazuar në rrethanat dhe informacionet e verifikuara, Policia e Shtetit mund të urdhërojë evakuimin e ndërtesave të cilat janë objekt i masës së sekuestros. Me udhëzim të ministrit të Brendshëm parashikohen kushtet e zbatimit të këtij urdhri.

3. Vendimi i formës së prerë së gjykatës kompetente për vënien e sekuestros zbatohet menjëherë. Sekretaria e gjykatës njofton dhe u vë në dispozicion kopje të vendimit subjektit palë në proces, prokurorit, drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.

4. Me marrjen dijani për vendimin e gjykatës për masën e sekuestros sipas parashikimit të pikës 4, të këtij neni, Agjencia, pas miratimit nga Komiteti mund të disponojë për dhënien e pasurisë së sekuestruar në përdorim institucioneve dhe enteve shtetërore në nivel qendror apo vendor, si dhe te

të tretët, mbështetur në parimet e miradministrimit të pasurisë dhe sipas rregullave e procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

Neni 21

Të drejtat e personave të tretë

1. Personat e tretë, të cilët rezultojnë pronarë ose bashkëpronarë të aseteve ose pasurive të sekuestruara, brenda afatit 30-ditor të vleftësimit të masës së sekuestros, thirren nga gjykata të ndërhyjnë në proces për të shprehur qëndrimin dhe pretendimet e tyre në lidhje me masën e sekuestros.

2. Personat e tretë duhet të provojnë se titulli i tyre i pronësisë nuk është i fituar apo i rrjedhur si rezultat i krimit të organizuar, veprimtarisë terroriste apo krimeve të rënda, të përcaktuara në këtë akt normativ.

3. Gjkata vendos heqjen e masës së sekuestros ose heqjen e sekuestros për pjesën takuese në rastet e bashkëpronësisë, të personave të tretë nëse këta të fundit arrijnë të provojnë para gjykatës sipas parashikimit të pikës 2 të këtij neni.

4. Dispozitat e këtij neni vlejnë edhe për personat e tretë të cilët gëzojnë të drejta reale ose të drejta të garantimit të aseteve apo pasurive të sekuestruara.

Neni 22

Raporti i masës së sekuestros parashikuar nga ky akt normativ me masat e sekuestros të parashikuara nga legjislacione të tjera

Kur pasuritë e subjekteve të këtij akti normativ janë vendosur nën sekuestro sipas parashikimit të këtij akti normativ, zbatimi i çdo mase sekuestroje të mundshme në kuadër të legjislacionit penal, legjislacionit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, apo legjislacionit për masat kundër financimit të terrorizmit, merr përparësi.

Neni 23

Konfiskimi i pasurisë

1. Masa parandaluese pasurore e konfiskimit për pasuritë që administrohen, posedohen ose janë në pronësi të subjekteve sipas parashikimit të nenit 16, të këtij akti normativ, vendoset me kërkesë të prokurorit, i cili i paraqet gjykatës në mënyrë të argumentuar arsyet ku bazohet kërkesa.

Gjkata vendos masën parandaluese pasurore të konfiskimit sipas parashikimit të kësaj pike, kur:

- mbi pasurinë është vendosur masa e sekuestros;
- ka dyshime të arsyeshme, bazuar në elemente të faktit, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale, të parashikuara në nenin 5 të këtij akti normativ;
- nuk mund të provohet përpara gjykatës origjina e ligjshme e burimit të krijimit të pasurisë apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, që janë shpërpjesëtimore dhe nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre.

2. Me kërkesë të prokurorit gjykata mund të vazhdojë gjykimin edhe në raste kur personi nuk ka banim të njohur brenda vendit, është larguar jashtë vendit ose me të gjitha kërkimet e bëra nuk gjendet. Në këtë rast, gjykata vendos mosgjatjen e personit, duke i caktuar atij një avokat. Avokati mund të caktohet kryesisht nga gjykata ose të zgjidhet nga të afërmit e personit.

3. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del se pasuritë u përkasin personave të tretë, gjykata, edhe kryesisht, me vendim të arsyetuar, i thërret ata për të ndërhyrë në proces. Personi i tretë, brenda afatit që i caktohet nga gjykata, ka të drejtë të paraqesë në seancë pretendimet e veta, si dhe të kërkojë marrjen e të dhënave të tjera të nevojshme.

4. Kur vërtetohet se disa pasuri i janë transferuar apo janë regjistruar në emër të të tretëve, me veprime juridike fiktive ose të simuluar, gjykata konstaton pavlefshmërinë e këtyre veprimeve juridike. Për këtë qëllim, kur nuk provohet e kundërta, prezumohen fiktive ose të simuluar edhe:

a) transferimet dhe regjistrimet në emër të të tretëve dhe me titull barrësor, të kryera brenda dy viteve përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e masës parandaluese kundër personave të afërm;

b) transferimet dhe regjistrimet në emër të të tretëve dhe me titull fals apo dukshëm nën vlerën e tregut, të kryera brenda dy viteve përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e masës parandaluese.

5. Në asnjë rrethanë subjektet e këtij akti normativ nuk mund të përdorin si argument apo provë se të ardhurat për krijimin apo fitimin e aseteve dhe pasurive, objekt hetimi, janë burim i evazionit fiskal. Të ardhurat e padeklaruara konsiderohen të paligjshme për sa subjekti nuk provon të kundërtën. Në këtë rast, kundër subjektit mund të ngrihet një proces i rregullt penal sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 24

Kohëzgjatja e gjykimit

1. Gjykata duhet të shprehet me vendim për konfiskimin e pasurive të sekuestruara, brenda 6 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës për konfiskim.

2. Nëse gjykata nuk shprehet me vendim për konfiskimin e pasurive të sekuestruara brenda afatit të vlefshmërisë së sekuestros sipas pikës 7, të nenit 19, me kërkesë të prokurorit apo Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, gjykata vendos për shtyrjen e afatit të sekuestros deri në përfundimin e këtij gjykimi.

3. Kundër vendimit të gjykatës për konfiskimin e pasurisë mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente të apelit, sipas afateve dhe kushteve, të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

Neni 25

Rishikimi i vendimit të konfiskimit

1. Rishikimi i vendimit përfundimtar të konfiskimit mund të kërkohej nga organi propozues i masës së konfiskimit ose subjektet e këtij akti normativ në rastet kur:

a) janë zbuluar prova të reja të cilat mund të kishin qenë vendimtare nëse do të ishin administruar në gjykimin e vendosjes së masës ose refuzimit të saj;

b) faktet dhe provat e reja përjashtojnë absolutisht ekzistencën e kushteve për aplikimin e konfiskimit;

c) vendimi përfundimtar për vendosjen e masës ose refuzimin e saj provohet se është marrë mbi prova të pavërteta ose të falsifikuara.

2. Procedura e shqyrtimit gjyqësor të rishikimit dhe ankimimit të vendimit të gjykatës për rishikimin është sipas rregullave, afateve dhe kushteve, të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

Neni 26

Kalimi i pasurive të konfiskuara në pronësi të shtetit

1. Pasuritë e konfiskuara me vendim gjyqësor, sipas këtij akti normativ, kalojnë në pronësi të shtetit.

2. Vendimi i formës së prerë për konfiskimin e pasurive i dërgohet brenda 24 orëve Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Kur vendimi i konfiskimit merr formë të prerë, pasuria kalon në pronësi të shtetit në mënyrë të pakthyeshme.

4. Kur vendimi i formës së prerë që ka vendosur konfiskimin priset nga gjykata më e lartë ajo vendos vetëm për njohjen e vlerës së pasurisë së konfiskuar mbajtësit apo zotëruesit të së drejtës së pronësisë.

Neni 27

Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi

1. Të gjitha vendimet dhe veprimet e ndërmarra nga organet dhe autoritetet përgjegjëse, në bazë të parashikimeve të këtij akti normativ trajtohen me përparësi, brenda afateve të caktuara në këtë

akt, pa vonesa të pajustificuara, duke siguruar që procesi në çdo fazë të tij të garantojë ruajtjen e sigurisë publike dhe proporcionalitetin e masës parandaluese.

2. Moszbatimi i parashikimit të pikës 1 të këtij neni përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor nga ana e institucioneve kompetente që inspektojnë veprimtarinë e organeve proceduese sipas këtij akti normativ.

3. Organet proceduese sipas këtij akti normativ në bashkëpunim me organet inspektuese nxjerrin udhëzime të posaçme mbi masat e nevojshme për të garantuar shqyrtimin me përparësi të procedurave të këtij akti normativ.

KREU IV MASAT PARANDALUESE ME KARAKTER EKONOMIK

Neni 28

Masa parandaluese me karakter ekonomik

1. Subjektet e këtij akti normativ, për të cilët është dhënë apo kërkuar nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit vendosja e një mase parandaluese me karakter pasuror apo personal, përjashtohen nga:

- a) e drejta për të marrë apo mbajtur leje, licenca dhe autorizime që jepen nga Policia e Shtetit ose ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë;
- b) përfitimi i fondeve në të gjitha procedurat e prokurimit të punëve apo kontratave publike;
- c) koncesionet publike dhe partnertëte publik-privat, si dhe të drejtat e lidhura me to;
- ç) përfitime apo kontribute, të llojit ndihmë shtetërore, hua, hipoteka të subvencionuara apo të mbështetura nga fonde publike.

2. Në rastet kur licencat, autorizimet, koncesionet, disbursimet apo dhënia e fondeve janë në proces shqyrtimi administrativ dhe nuk ka ende një vendimmarrje, nuk lejohet vazhdimi i procedurës në favor të subjekteve të këtij akti normativ.

3. Kundër masave me karakter ekonomik subjektet e interesuara mund të ankimohen sipas procedurës të parashikuar në legjislacionin në fuqi që rregullon aktivitetin apo veprimtarinë sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni.

4. Autoritetet proceduese sipas legjislacionit përkatës të fushës sipas pikës 1 janë të detyruara të konsultojnë të dhënat e regjistrit sipas parashikimit të këtij akti normativ përpara procedimeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni.

5. Ndaj personave të përcaktuar në nenin 5 të këtij akti normativ, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me iniciativën e vet apo me kërkesë drejtuar institucioneve kompetente, vendos revokimin / heqjen e licencës apo ndalimin e pajisjes me leje apo autorizime, apo ndalimin e përdorimit, pjesërisht ose plotësisht, të çdo pajisjeje komunikimi që transmeton radio, radar dhe mjete optike për shikim natën, veshje dhe aksesore për mbrojtje balistike individuale, mjete transporti të blinduara ose të modifikuara për të rritur fuqinë e tyre ose aftësinë, ose në çdo rast të dizajnuar për të shmangur kontrollin e policisë, armë dhe riprodhime armësh të çdo lloji, instrumente të tjera të afta për të shpërndarë lëngje irrituese ose përzierje të papërshtatshme për të shkaktuar dëme të njerëzimit, produkte piroteknike të çdo lloji, si dhe substanca të ndezshme dhe mjete të tjera të përshtatshme që shkaktojnë lëshimin e flakëve, si dhe programet kompjuterike apo mjetet e tjera që shërbejnë për kriptimin e bisedave dhe mesazheve.

6. Mosveprimi ose refuzimi për të vepruar në përputhje me parashikimet e këtij neni nga ana e institucioneve apo organeve kompetente përbën shkak për procedimin e tyre në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Neni 29

Detyrimi i deklarimit të pasurisë

1. Subjektet e këtij akti normativ, ndaj të cilëve është vendosur një masë parandaluese, sipas parashikimeve të këtij akti normativ, kanë detyrimin që:

- a) brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti kur masa parandaluese është bërë përfundimtare, të deklarojnë pranë strukturave të OFL-së pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme që disponojnë;

b) të deklarojnë pranë strukturave të OFL-së të gjitha ndryshimet në pasurinë e tyre me një vlerë jo më pak se 5 000 000 lekë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga kryerja e ndryshimit;

c) të deklarojnë pranë strukturave të OFL-së çdo transaksion financiar me vlerë mbi 1 000 000 lekë, brenda 30 ditëve nga kryerja e tij.

2. Deri më 31 mars të vitit 2021, subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, duhet të bëjnë deklaratimet pasurore mbi të ardhurat vjetore, shtesat, pakësimet dhe ndryshimet e pasurisë përgjatë vitit 2020.

KREU V STRUKTURAT PËRGJEGJËSE DHE KONTROLLI I LIGJSHMËRISË

Neni 30

Strukturat përgjegjëse në Policinë e Shtetit

1. Për efekt të zbatimit të këtij akti normativ, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ngrihet një strukturë e posaçme e quajtur Operacioni Forca e Ligjit (OFL), në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, e drejtuar nga drejtori i Departamentit të Policisë Kriminale. OFL-ja së bashku me Drejtorinë e Antiterrorit janë strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit për zbatimin e dispozitave të këtij akti normativ.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e OFL-së janë mbledhja e informacioneve, përditësimi, përpunimi i të dhënave dhe kryerja e çdo veprimi administrativ, procedural e hetimor që parashikohet për Policinë e Shtetit, në zbatim të këtij akti normativ, si dhe detyra të tjera të përcaktuara me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

3. Në përmbushje të detyrave të veta, OFL-ja asistohet dhe bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore që ngarkohen me zbatimin e këtij akti normativ, si edhe nga ekspertë të fushës, organizata dhe agjenci partnere të huaja ligjzbatuese.

4. Struktura, organizimi dhe funksionimi i OFL-së miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ndërsa trajtimi financiar i punonjësve të OFL-së dhe Drejtorisë së Antiterrorit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 31

Organizimi i OFL-së

1. OFL-ja ka në përbërje të saj punonjës të Policisë së Shtetit dhe ekspertë të fushave të ndryshme. Për çështje komplekse, nisur nga nevoja dhe natyra e çështjeve, OFL-ja mund të kontrakttojë ekspertë të fushave të ndryshme.

2. OFL-ja përfaqëson Policinë e Shtetit në çështjet, objekt shqyrtimi gjyqësor, sipas parashikimeve të këtij akti normativ.

3. Përveç aksesit në *database*-in e Policisë së Shtetit, OFL-ja ka akses në informacionin apo bazën e të dhënave të institucioneve publike, përfshirë Sistemin e Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS).

Neni 32

Detyrimi i dorëzimit të informacionit dhe të dokumenteve

1. Policia e Shtetit kërkon pranë çdo zyre të administratës shtetërore, enti a personi juridik publik, personave të tjerë fizikë dhe juridikë, të dhëna e kopje të dokumenteve, që vlerësohen si të domosdoshme për qëllime verifikimi ndaj pasurive të personave të parashikuar në nenin 5, të këtij akti normativ.

2. Me autorizim të lëshuar nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, mund të vendosin sekuestrimin e dokumenteve të shqyrtuara, sipas rregullave të parashikuara në nenet 208, 209, 210 dhe 211, të Kodit të Procedurës Penale, si dhe rregullave të parashikuara në këtë akt normativ.

3. Institucionet, entet apo personat juridikë publikë, personat fizikë dhe juridikë, që nuk zbatojnë detyrimet sipas parashikimeve të këtij neni, përgjigjen dhe mbajnë përgjegjësi sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 33

E drejta për akses të menjëhershëm

1. Kur në bazë të informacioneve që disponohen nga OFL-ja/Njësia Antiterror në Policinë e Shtetit dyshohet se subjekti i këtij akti normativ po planifikon, organizon apo merr pjesë në kryerjen e një krimi të organizuar apo veprimtarie terroriste dhe kjo veprimtari nuk mund të zbulohet dhe të parandalohet në mënyra të tjera apo me aplikimin e masave parandaluese të parashikuara nga ky akt normativ, drejtuesi i OFL-së, vetëm ose në bashkëpunim me drejtuesin e Njesisë së Antiterrorit, nëse jemi në kushtet e dyshimit për veprimtari terroriste, mund të kërkojë akses për strukturat e policisë:

a) në operatorët që përdorin rrjetet dhe ofrojnë përdorimin e shërbimeve elektronike e telefonike të çdo lloji, për identifikimin në kohë reale të subjektit a numrit të telefonit, të numrit të aparatit telefonik (IMEI) apo lokalizimin e antenave loguese të dy komunikuesve, si dhe krijimin e mundësive të identifikimit të përdoruesit fundor të internetit;

b) në operatorët që përdorin rrjetet dhe ofrojnë përdorimin e shërbimeve elektronike për komunikimin dhe postën elektronike, përfshirë internetin, ndër të tjera, edhe për identifikimin në kohë reale të përdoruesve të internetit me IP publike;

c) në *database* e regjistra elektronikë të institucioneve shtetërore dhe subjekteve private të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Mbi veprimet e kryera sipas parashikimit më sipër, drejtuesi i OFL-së informon drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe prokurorin kompetent, sipas parashikimeve të këtij akti normativ.

Neni 34

Kontrolli i ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga policia

1. Punonjësit e OFL-së dhe të Drejtorisë së Antiterrorit, gjatë gjithë veprimtarisë së tyre në zbatim të këtij akti normativ, monitorohen dhe kontrollohen në mënyrë të posaçme nga strukturat eprorë hierarkike për ligjshmërinë e kryerjes së veprimeve dhe tejkallim të kompetencave.

2. Shërbimi i Çështjeve të Brendshme e Ankesave në Ministrinë e Brendshme ushtron kontrolle të posaçme lidhur me zbatimin korrekt të këtij akti normativ.

Neni 35

Shpërdorimi dhe abuzimi me informacionin dhe kompetencën

Kryerja e veprimeve jo të ligjshme, abuzuese dhe në tejkallim të kompetencave, në zbatimin e masave të përcaktuara në këtë akt normativ nga punonjësit e OFL-së përbën vepër penale dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI DOKUMENTIMI

Neni 36

Regjistri i masave parandaluese

1. Për qëllime të zbatimit të këtij akti normativ, në Policinë e Shtetit krijohet, mirëmbahet dhe administrohet, në *hard copy* dhe në formë të digjitalizuar regjistri i masave parandaluese, në të cilin kanë akses si përdorues edhe prokuroria dhe gjykata kompetente sipas parashikimeve të këtij akti normativ.

2. Në regjistrin sipas pikës 1 evidentohen të dhënat për emrin e personit fizik dhe/ose juridik ndaj të cilit janë dhënë masat parandaluese sipas parashikimit të këtij akti; gjenealitetet e personave; identifikimi i pasurisë, lloji dhe afatet e masës, faza dhe procedura e zbatimit të masave paraprake, përshkrim i të dhënave mbi çështjen dhe çdo informacion i nevojshëm sipas udhëzimit të përmendur në pikën 3, të këtij neni

3. Formati, mënyra e mbajtjes së regjistrit, ndërveprimi ndërmjet institucioneve që kanë të drejtë përdorimi të tij përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë, ministrit të Brendshëm pas marrjes së mendimit të drejtuesit të prokurorisë dhe gjykatës kompetente sipas përcaktimit të këtij akti normativ.

Neni 37

Baza e të dhënave shtetërore për krimin e organizuar dhe terrorizmin

1. Baza e të dhënave shtetërore mbi informacionin për krimin e organizuar dhe terrorizmin krijohet pranë Policisë së Shtetit dhe administrohet nga struktura e posaçme e OFL-së.

2. Baza e të dhënave shtetërore mbi informacionin për krimin e organizuar dhe terrorizmin përmban të dhënat, si më poshtë:

a) çdo vendim penal, pavarësisht nëse kanë marrë formë të prerë ose jo, për një nga veprat penale të parashikuara në nenin 5 të këtij akti normativ;

b) çdo vendim penal të dhënë jashtë shtetit ndaj shtetasve shqiptarë ose të huaj ose pa shtetësi, por me banim në shtetin shqiptar për një nga veprat penale të parashikuara në nenin 5 të këtij akti normativ;

c) çdo vendim mosfillimi të procedimit, pushimit të akuzës ose çështjes ose për dërgimin e çështjes në gjyq për një nga veprat penale të parashikuara në nenin 5 të këtij akti normativ;

ç) çdo vendim për marrjen e masave parandaluese personale sipas parashikimeve të këtij akti normativ; dhe

d) çdo vendim për marrjen e masave parandaluese me karakter pasuror dhe ekonomik, të marrë sipas parashikimeve të këtij akti normativ ose sipas parashikimeve të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.

3. Regjistrohen si të dhëna parësore në këtë bazë të dhënash elementet e mëposhtme:

a) gjykata ose autoriteti tjetër që e ka dhënë;

b) gjenealitetet e të pandehurit, të të dënuarit ose të shtetasit ndaj të cilit është marrë vendimi sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, ose janë marrë masat parandaluese sipas shkronjave “ç” dhe “d”, të pikës 2, ose të dhëna të tjera personale që vlejné për ta identifikuar, si dhe gjenealitetet e palëve të tjera private;

c) akuza ose lloji i masës parandaluese personale ose me karakter pasuror;

ç) parashtrimi i përmbledhur i rrethanave të faktit;

d) dispozitivi;

dh) data dhe vendi i marrjes së vendimit.

4. Baza e të dhënave sipas këtij akti normativ ndërvepron me bazat e të dhënave të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë vendase dhe të autoriteteve juridiksionale të huaja në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit reciprok.

5. Këshilli i Ministrave miraton rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave mbi informacionin kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe terrorizmit me bazat e tjera të të dhënave, si dhe nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara në këtë bazë të dhënash.

KREU VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 38

Koha e zbatimit të aktit normativ

Ky akt normativ ka efekt të përkohshëm dhe do të zbatohet deri më 31.12.2020.

Neni 39

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

